



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. 520

Tiranë 19/6/2025

VENDIM

Nr. 18, datë 19.6.2025

PËR

NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE AFATGJATA
MATERIALE “SISTEM SIGURIMI” DHE “PIKË AKSESI SISTEM
KOPJUTERIK WIRELESS”, NËPËRMJET PROCEDURËS SË ASGJËSIMIT

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “f”, të nenit 53, pika 6, shkronja “b” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 3, të nenit 22, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3 shkronja “a”, dhe të nenit 23, pika 1, shkronja “b” të Rregullores nr. 5, datë 30.03.2017 “Për administrimin e aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18 të Rregullores nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale “Sistem sigurimi”, me kod unik identifikimi të aktivitetit 701385, dhe “Pikë aksesi sistem kopjuterik wireless”, me kod unik identifikimi të aktivitetit 652550, nëpërmjet procedurës së asgjësimit.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për mbikëqyrjen e punës të njësisë organizative të Agjencisë, për zbatimin e këtij vendimi, dhe informimin e Këshillit Drejtues mbi zbatimin e tij.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

